

**PROJEKTLIGJ PËR FALJEN E MASAVE NDËSHKIMORE
TË VENDOSURA GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË COVID-19**

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJIN NR. 08/L-__ PËR FALJEN E MASAVE NDËSHKIMORE TË VENDOSURA GJATË PERIUdhËS SË PANDEMISË COVID-19

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është falja e masave ndëshkimore, të shqiptuara nga Institucionet Shtetërore të Republikës së Kosovës, si dhe përcaktimi i procedurave në lidhje me faljen e këtyre masave, të shqiptuara në zbatim të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1 Masa ndëshkimore – për qëllim të këtij ligji, nënkupton çdo masë ndëshkimore, e cila është shqiptuar nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës.

1.2 Gjobë e paguar – për qëllim të këtij ligji, nënkupton çdo gjobë, e cila është paguar , përfshirë ndëshkimet, interesin si dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë si masë ndëshkimore, e aplikuar në bazë të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës

1.3. Institucionet Shtetërore të Republikës së Kosovës - për qëllim të këtij ligji, nënkupton institucionet të cilat kanë shqiptuar masat ndëshkimore, në të cilat përfshihen Policia e Kosovës, Inspektorati shëndetësor, inspektorati farmaceutik, inspektorati sanitar dhe inspektoratet komunale.

1.4. Person - për qëllim të këtij ligji, nënkupton të gjithë personat fizik dhe personat juridik privat (jo publik), të cilët janë subjekt i masave ndëshkimore të shqiptuara nga Institucionet Shtetërore të Republikës së Kosovës, e të ndërlidhura me parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19.

KAPITULLI II PËRFITUESIT E FALJES NGA MASAT NDËSHKIMORE

Neni 3

Falja e masave ndëshkuese

1. Falen të gjitha masat ndëshkuese, të shqiptuara nga institucionet shtetërore përkatëse, gjatë periudhës: 15 mars 2020, që nga Vendimi i Qeverisë së Kosovës për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik deri me 28 gusht 2020.
2. Falen të gjitha masat ndëshkuese, të shqiptuara nga institucionet shtetërore përkatëse, për shkeljen e dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, deri me 15 maj 2021

Neni 4

Përfshirjet nga Falja

1. Pavarësisht Nenit 3 të këtij Ligji, nga falja përfshihen:
 - a) Subjektet politike në Republikën e Kosovës, sipas Regjistrimit të partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për periudhën nga data 15 mars 2020 deri me 1 mars 2021, për masën ndëshkimore të shqiptuar në bazë të Nenit 26, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës;
 - b) Personat që kanë shkelur obligimin e izolimit dhe karantinimit, për afatin e përcaktuar nga organi kompetent, masë ndëshkimore e paraparë në bazë të Nenit 26 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës;

Neni 4
Kthimi i mjeteve të shlyera/paguara

1. Të gjitha institucionet shtetërore, do t'i kthejnë shumat e shlyera/paguara, për masat ndëshkuese me gjobë, të cilat do të merren nga zëri përkatës i buxhetit të shtetit apo buxhetit të institucionit në të cilin është arkëtuar shuma, me urdhër të nëpunësit të parë autorizues, dhe kalohet në mënyrë automatike në llogarinë bankare të individit ose në mungesë të saj kjo shumë i dërgohet institucionit shtetëror që ka vendosur masën me gjobë për t'ia dorëzuar subjektit përfitues.
2. Të gjitha institucionet shtetërore, janë të detyruara që, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të përgatisin listat e personave ndaj të cilëve është vendosur masa ndëshkuese, duke përfshirë shumën si dhe të dhënat e nevojshme për kthimin e saj.

KAPITULLI III
DISPOZITAT KALIMTARE DHE HYRJA NË FUQI

Neni 5
Aktet nënligjore

Jo më vonë se një muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Qeveria e Kosovës, miraton akt nënligjor, i cili do të rregullojë në mënyrë të hollësishme zbatimin e këtij ligji.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Glauk Konjufca

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës